RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Komunikatë

Bordi themelon Grupin Punues për përzgjedhjen e Drejtorit të RTK 2

Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës themeloi sot Grupin Punues për Përzgjedhjen e Drejtorit të Kanalit Televiziv në gjuhën serbe.

Bazuar në Ligjin për RTK-në, Grupi Punues përmbëhet nga shtatë anëtarë, katër prej tyre janë serbë, dy shqiptarë dhe një i përkatësisë boshnjake.

Bordi me shumicë të votave themeloi grupin shtatë anëtarësh nga një listë prej 23 kandidatëve që kanë aplikuar në thirrjen publike.

Pas themelimit të Grupit Punues, Bordi miratoi shpalljen e konkursit publik për Drejtor të Kanalit Televiziv në gjuhën serbe në RTK.